

Durrës, më 09.05.2017

Bashkim Kopliku

Mobile: +355(0)672858090

Phone: +355(0)52 223663

E-mail: bkopliku@gmail.com

Adresa: L. 12, Rr. Mozaikëve, P. 917, Durrës

Nga babi ka pasur disa probleme, ndërsa nga pjesa e nënës jo

Intervistë e paditësit z. Bujar Nishani, datë 27.12. 2013, dhënë TV Klan

Marrë nga interneti, me shkurtime, nga Bashkim Kopliku, në adresën e Presidencës:

<http://president.al/?p=13798>

Gazetari: *Thatë që jeni lindur dhe rritur në qytetin e Durrësit, me mbiemrin Nishani që i bie të jeni nga zona e Gjirokastrës, ndodheni në Durrës, si, në ç'rrethana?*

Presidenti Nishani: Në fakt, origjina e familjes është nga Libohova e Gjirokastrës, mbiemri origjinal i familjes ka qenë Beu. Pas mbarimit të Luftës së II-të botërore ishte e vështirë të mbaje mbiemrin Beu, kështu që lëvizëm nga Gjirokastra dhe u vendosëm në Durrës.

[...]

Gazetari: *Pra familja u vendos menjëherë pas Luftës së II-të Botërore?*

Presidenti Nishani: Pjesa më e madhe.

Gazetari: *Me se merreshin prindërit tuaj?*

Presidenti Nishani: Të dy prindërit i kam pasur arsimtar, babai ka shërbyer rreth 40 vjet në gjimnazin e Durrësit, nëna gjithashtu arsimtare po në Durrës derisa ka dalë në pension.

Gazetari: *Ju keni lindur në Durrës, në çfarë moshe jeni larguar nga Durrësi?*

Presidenti Nishani: Unë jam larguar në moshën 14-vjeçare për shkak të shkollës që unë zgjodha të ndjek, që ishte shkolla ushtarake.

Gazetari: *E zgjodhët apo ju dërguan?*

[...]

Gazetari: *Familja juaj ka pasur ndonjë problem me komunizmin?*

Presidenti Nishani: **Nga babi ka pasur disa probleme, ndërsa nga pjesa e nënës jo.**

[...]

Gazetari: *Çfarë keni përfituar?*

Presidenti Nishani: Në karakter, në tip, në mënyrë të të menduarit, në mënyrë të të sjellurit, në mënyrë të qëndresës.

azetari: *Ishte e vështirë shkolla Skënderbeg në vetvete?*

Presidenti Nishani: Ka qenë e vështirë sepse ti limitoheshe, kufizoheshe nga mjaft gjëra.

[...]

Gazetari: *A kishit ju besim në një karrierë tuajën ushtarake?*

Presidenti Nishani: Po kam pasur, kam pasur edhe për faktin që degën që unë zgjodha për të studiuar në shkollën e lartë në Akademi, kishte të bënte me atë që u quajt Fakulteti i gjithanshëm në atë kohë që ishte pjesë e karrierës, pra e linjës së komandimit ku përfshiheshin të gjitha degët bashkë.

Gazetari: *Çfarë specialiteti kishit në shkollën e mesme, apo shkolla e mesme ishte e përgjithshme?*

Presidenti Nishani: Shkolla e mesme ishte tërësisht si një gjimnaz.

Gazetari: *Në shkollën e lartë për çfarë u specializuat?*

Presidenti Nishani: Këtë që thashë, pra të komanduesit të gjithanshëm, që ti në një karrierë normale mbërrije deri në drejtues brigade, në komandues divizioni, në karrierën më maksimale të mundshme.

[...]

Gazetari: *Ishte një ushtri serioze ajo që komunizmi ngriti?*

Presidenti Nishani: Absolutisht. Në fakt, njerëzit që shkonin dhe e studionin ishin njerëzit që e merrnin me seriozitetin më të madh, sepse niseshin nga parimi për t'i shërbyer vendit. Së pari ideologjia, së dyti mentaliteti i kurikulës që ju e përmendët, së treti interesi i mëpasshëm solli degradimin në tërësi.

[...]

Gazetari: *Brenda ushtrisë kishte një zë ose një rrymë mendimi që kjo gjë po ndodhte, apo as nuk mendohej?*

Presidenti Nishani: Unë nuk e kam konstatuar, por në ndryshimet që ndodhën në vitet '90 edhe gjatë kohës kur studentët u ngritën në Tiranë.

Gazetari: *Ju ishit student në kohën e protestave?*

Presidenti Nishani: Unë kam qenë pedagog.

Gazetari: *Në cilin vit filluat pedagog?*

Presidenti Nishani: Në vitin '88, në kohën që mbarova shkollën.

Gazetari: *Me rezultate të larta?*

[...]

Gazetari: *Në një nga komentet që kam lexuar më pas thuhej se, të paktën dy momente të rëndësishme kur ushtria duhet të funksiononte, pavarësisht shumë të ndryshme si momente, nuk funksionoi, në 7 prill të vitit 1939 dhe '97. Në një rast kur duhet të mbronte vendin nga një agresion i huaj dhe në një rast që duhet të mbronte depot e saj të armëve nga sulmet e brendshme?*

Presidenti Nishani: Unë mbetem i bindur se depot e repartit ushtarak duhen mbrojtur me rregulla ushtarake, por ngjarjet e '97-tës patën një precipitim të tillë ku u përfshi politika, ekonomia, antishteti, antiligji, u përfshinë shumë gjëra së bashku.

Gazetari: *Pra, ishte një zgjidhje politike dhe jo ushtarake?*

Presidenti Nishani: Pa diskutim.

[...]

Gazetari: *Cilat kanë qenë marrëdhëniet e tua me ish-kreun e Partisë Demokratike, zotin Berisha, kur e keni njohur?*

[...]

Printuar e shkurtuar nga

Bashkim Kopliku

Durrës, më 29.04.2017

Mobile: +355(0)672858090

Phone: +355(0)52 223663

E-mail: bkopliku@gmail.com

Adresa: L. 12, Rr. Mozaikëve, P. 917, Durrës